

RELACION

Për monitorimin e buxhetit për vitin 2017 të programit buxhetorë “Mbetje Urbane”

Në buxhetin e vitit 2017 për këtë program buxhetor janë planifikuar:

1. Për projektin “Administrimi i mbetjeve të ngurta në Juglindje të Shqipërisë, Faza e dytë”, është planifikuar mbështetja buxhetore financim i huaj me vlerë 340,000,000 lekë. Për këtë produkt është planifikuar mbështetja buxhetore me TVSH 160,000,000 lekë. Nga monitorimi i produktit për vitin 2017 rezulton se nuk janë disbursuar nga financimi i huaj 515,981,000 lekë dhe nga financimi i brendshëm janë disbursuar 72,253,823 lekë. Problematika gjatë zbatimit të projektit ka qenë pengesa e ndërtimit të stacionit të transferimit të mbetjeve në Pogradec nga bonorët e zonës.
2. Financimi i produkteve “Studim i përfunduar për mbylljen e venddepozitave ekzistuese të mbetjeve të ngurta”, në Durrës, Sarandë, Cërrik, Belsh, Librazhd dhe Prrenjas.. Për këtë produkt është planifikuar për 2017 mbështetja buxhetore në vlerën totale 25.300.000 lekë të gjithë studimeve dhe janë disbursuar 25,072,000 lekë. Financimi i produktit “Studim i përfunduar për mbylljen e venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta”, në Himarë nuk është realizuar.
3. Financimi i produktit “Venddepozitimi i Bushatit i ndërtuar”(faza II), ishte planifikuar me vlerë 40,700,000 lekë. Në dijeninë e sektorit tonë dhe si anëtarë të EMP nuk është bërë ndonjë kërkesë për rialokim fondi për projektin "Ndërtimi i venddepozitimit Bushat (faza II)". Për vitin 2018 ishin planifikuar 40,700,000 lek, ndërkohë që rezulton realizimi i buxhetit në vlerën 102,320,000 lekë. Kjo vlerë ishte parashikuar për tre vitet buxhetore 2018-2020. Theksojmë se, pranë sektorit tonë nuk është dorëzuar asnjë raport monitorimi lidhur me ecurinë e këtij projekti.
4. Financimi i produktit “Studim për sistemin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Qarkun e Beratit”, me vlerë 18.000.000 lekë nuk është realizuar për arsye të procedurave të nënshkrimit të marrëveshjes së financimit.

5. Financimi i produktit “Siperfaqe landfilli e ndertuar në rajonin e Vlorës”, me vlerë 89.200.000 lekë nuk është realizuar për arsye të procedurave të nënshkrimit të marrëveshjes së financimit.

6. Projektet e Inceneratorëve të Fierit dhe Elbasanit janë transferuar nga Ministria e Mjedisit dhe nuk kemi asnjë raport monitorimi lidhur me ecurinë e këtyre projekteve. Kemi plotësuar sipas të dhënave të buxhetit planifikimn dhe faktin e realizimit për vitin 2017.

Alba Canaj
Drejtore

Konceptoi: Isa Memia

Datë: 26/02/2018

Miratoi: Bujar Abazaj